



Republika e Kosovës – Republika Kosova – Republic of Kosovo

ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD
WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE



RAPORTI VJETOR 2009

Prishtinë
mars 2010

Vizioni

“Shërbime cilësore, të sigurt, dhe efikente të ujit dhe mbeturinave për të gjithë konsumatorët në tërë Kosovën.”

Misioni

“Rregullimi i shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave të ngurta në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit dhe të mbeturinave japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit publik.”

Përmbajtja

PËRMBAJTJA.....	3
1. PARATHËNIE.....	4
2. STATUSI LIGJOR DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM.....	6
2.1. AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM	6
2.2. PARIMET UDHËHEQËSE TË PUNËS SË ZRRUM	6
2.3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUM	7
2.4. DEPARTAMENTET E ZRRUM	9
3. AKTIVITETET RREGULLATORE TË ZRRUM	10
3.1. LICENCIMI.....	10
3.2. MONITORIMI I PERFORMANSËS	14
3.3. TARIFAT E SHËRBIMIT.....	25
3.4. PROMOVIMI I INTERESAVE TË KONSUMATORËVE.....	30
4. AKTIVITETET NË KONSOLIDIMIN INSTITUCIONAL	31
4.1. AKTIVITETET NË PLANIN LEGJISLATIV DHE TË ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM	31
4.2. STATUSI FINANCIAR I ZRRUM	32
4.3. MBËSHTETJA FINANCIARE NGA DONATORËT.....	32
5. RELACIONET E JASHTME.....	33
5.1. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT DHE INSTITUCIONET TJERA NË KOSOVË.....	33
5.2. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT E UJIT NË REGJION DHE NË EUROPË	34
5.3. BASHKËPUNIMI ME MEDIA - RELACIONET ME PUBLIKUN	35
6. ASPEKTET FINANCIARE	35
6.1. SHPENZIMET	35
6.2. MBËSHTETJA NGA DONATORËT	36
6.3. TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT	36
6.4. ASETET E ZRRUM.....	38

1. Parathënie

Kam kënaqësinë e veçantë që përmes këtij raporti të ju prezantoj aktivitetet e Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) të realizuara gjatë vitit 2009. Me këtë rast mund të konstatoj se gjatë vitit 2009 ZRRUM në mënyrë të suksesshme ka përballuar sfidat që ka pasur para veti dhe rrjedhimisht i ka përmbushur me sukses synimet e përcaktuara.

Gjatë vitit 2009, ZRRUM ka vazhduar të përforcojë funksionet e veta rregullatore në katër fusha kryesore:

- (i) **Përforcimi institucional dhe ngritja e kapaciteteve të brendshme** me qëllim të ngritjes së cilësisë dhe kredibilitetit të procesit rregullator;
- (ii) **Avansimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës** së kompanive të ujit dhe mbeturinave me qëllim të ngritjes së cilësisë së këtyre shërbimeve;
- (iii) **Avansimi i procesit tarifar** me qëllim të ngritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave;
- (iv) **Bashkëpunimi me palët e interesit** me qëllim krijimit të një kornize ligjore dhe institucionale efektive që mundëson veprim të harmonizuar dhe inkluziv në krijimin e sektorëve të qëndrueshëm të ujit dhe mbeturinave në Kosovë.

Në planin institucional ZRRUM në vitin 2009 e ka avancuar mëtutje çështjen e pavarësisë së vet operative dhe në veçanti të pavarësisë financiare në financimin e veprimtarisë së vet përmes taksave të cilat i paguajnë kompanitë e rregulluara. Poashtu, në këtë plan ZRRUM ka vazhduar amendamentimin e legjislacionit sekondar si dhe kompletimin e politikave dhe procedurave të brendshme administrative. Dhe jo më pak me rëndësi është edhe vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve të stafit në fusha të ndryshme si: prokurimi, monitorimi i performancës, menaxhimi i aseteve etj. Përkundër këtyre zhvillimeve pozitive, çështja e paqartësive sa i përket kompetencave dhe përgjegjësisë institucionale në sektorin e mbeturinave ka mbetur ende e pazgjidhur përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të ZRRUM që të adresohet ky problem. Shpresoj që i njëjti të zgjidhet përfundimisht në vitin vijues.

Në anën tjetër, duke qenë një prej aspekteve më të rëndësishme të punës së ZRRUM, avancimi i mëtutjeshëm i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës ka vazhduar të ketë një rëndësi të veçantë në aktivitetet e ZRRUM edhe në vitin 2009. Në këtë kuadër, ZRRUM ka publikuar dhe shpërndarë raportin vjetor të performancës së kompanive të ujit dhe mbeturinave për vitin 2008, në të cilin raport është dhënë një përmbledhje e zhvillimeve në sektorët e ujit dhe mbeturinave në Kosovë si dhe janë analizuar treguesit financiar, operativ dhe të nivelit të shërbimeve të 16 ndërmarrjeve publike që i rregullon ZRRUM.

Poashtu, si edhe vitet e mëparshme ZRRUM ka shpallur dhe ka ndarë çmimet për kompanitë me performancën më të mirë me qëllim të nxitjes së konkurrencës ndërmjet këtyre ndërmarrjeve. Zhvillimi i takimeve të veçanta me Bordet dhe menaxhmentin e kompanive të ujësjet sit në të cilat është diskutuar performanca e tyre dhe janë nxjerrë rekomandimet për përmirësimin e treguesve të punës së tyre ka qenë një aktivitet me interes për të gjitha palët.

Avansimit të procesit tarifar, ZRRUM i ka kushtuar një pjesë të madhe të angazhimit të tij edhe në vitin 2009. Në këtë kontekst ZRRUM ka monitoruar sistematikisht efektet e tarifave të përcaktuara për periudhën 2009-2011 duke shqyrtuar në veçanti dinamikën e realizimit të investimeve kapitale. Në këtë plan ZRRUM ka konstatuar me keqardhje se investimet e planifikuara nuk janë realizuar as për së afërmi qoftë në vlerën dhe poashtu në dinamikën e planifikuar. Ky mbetet një shqetësim serioz i ZRRUM për zhvillimet në sektor të cilin ZRRUM e ka shprehur në takimet që ka zhvilluar gjatë vitit 2009 me menaxhmentet e kompanive të ujit dhe mbeturinave si dhe me palët tjera të interesit.

ZRRUM gjatë vitit 2009 ka vazhduar bashkëpunimin me të gjitha palët e interesit në Kosovë, në veçanti me Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave (MEF), pastaj me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MMPH), me SHUKOS-in (Shoqatën e ndërmarrjeve publike të ujësjellësit dhe kanalizimit), Agjencinë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM), Agjencinë për Integritet Europian si dhe me donatorët. Në planin e bashkëpunimit me rregullatorët e ujit të vendeve tjera, ZRRUM gjatë vitit 2009 përpos që ka vazhduar me bashkëpunimin me rregullatorët ekonomik të ujit të Shqipërisë, Skotlandës dhe Portugalisë, ka nënshkruar Marrëveshje të Bashkëpunimit me Entin Rregullator të Ujit të Shqipërisë duke formalizuar kështu bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me këtë institucion.

ZRRUM edhe në vitin 2009 ka vazhduar të angazhohet me intensitet të shtuar në mbrojtjen e interesave të konsumatorëve. Aktivitetet që ka ndërmarrë ZRRUM në këtë plan kanë ndikuar në vetëdijësimin më të madh konsumatorëve për të drejtat dhe obligimet e tyre si dhe për krijimin nga ana e kompanive të një qasjeje më të fokusuar kah konsumatorët.

Duke pasur parasysh se angazhimi im në ZRRUM përfundon së shpejti, dëshiroj që ta shfrytëzoj këtë rast për të shprehur falënderimin tim të singertë për bashkëpunimin që më është ofruar gjatë këtyre viteve nga të gjitha institucionet me të cilat ZRRUM ka bashkëpunuar. Në veçanti dëshiroj të falënderoj të gjithë personelin e ZRRUM për punën e përkushtuar që kanë demonstruar gjatë gjithë këtyre viteve në përmbushjen e objektivave të cilat i kemi parashtruar bashkarisht duke krijuar një standard të lartë profesional që unë e konsideroj vlerën më të madhe për të ardhmen e ZRRUM.

Afrim Lajçi
Drejtör i ZRRUM

2. Statusi Ligjor dhe Përgjegjësitë e ZRRUM

2.1. AUTORIZIMET DHE PËRGJEGJËSITË E ZRRUM

Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) është rregullator ekonomik i sektorëve të ujit dhe mbeturinave në Kosovë i themeluar më 26 nëntor të vitit 2004 me [Rregulloren e UNMIK 2004/49](#) në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Rregullorja 2004/49 është amendamentuar me [Ligjin Nr. 03/L-086](#) të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës më datë 13 qershor 2008 duke transferuar kështu përgjegjësitë për rregullimin e sektorëve të ujit dhe mbeturinave nga UNMIK tek Kuvendi i Kosovës.

ZRRUM është autoritet i pavarur, që ka përgjegjësi rregullimin e Ndërmarrjeve Publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit, mbledhjes së mbeturinave, dhe deponimit të mbeturinave.

Përgjegjësitë kryesore të ZRRUM janë:

- [Përcaktimi i tarifave](#) që balancojnë nevojat e konsumatorëve për çmime të përballueshme dhe ruajtjen e integritetit financiar të ofruesve të shërbimeve;
- [Dhënia e licencave](#) për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe mbeturinave;
- [Mbrojtja e interesave të konsumatorëve](#) duke siguruar që ofruesit e shërbimeve nuk keqpërdorin pozitën e monopolit dhe duke siguruar që shërbimet ofrohen në pajtim me standardet adekuate dhe të përcaktuara të shërbimit;
- [Monitorimi dhe raportimi i performancës](#) së ofruesve të shërbimeve;
- [Përcaktimi i procedurave dhe kushteve për shkyçje](#) individuale dhe kolektive të konsumatorëve nga rrjeti i ujësjellësit;
- [Themelimi i Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve](#) dhe mbështetja e punës së tyre;
- [Miratimi i kushteve për falje dhe shlyerje të borxheve të vjetra.](#)

Pra, ZRRUM është përgjegjës për të siguruar se ndërmarrjet publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe mbeturinave në Kosovë iu ofrojnë konsumatorëve shërbime efikente dhe cilësore me çmim të arsyeshëm dhe korrekt.

Në përmbushjen e përgjegjësiave të veta rregullatore, ZRRUM udhëhiqet nga korniza ligjore që është përcaktuar me Rregulloren 2004/49 dhe Ligjin Nr. 03/L-086 si dhe legjislacionin tjetër që ka të bëjë me sektorët e ujit dhe mbeturinave. Në mënyrë më të hollësishme korniza ligjore është përcaktuar me legjislacionin sekundar (në formën e 14 Rregullave) të nxjerrë nga ZRRUM në Janar të vitit 2005 dhe të amendamentuar kohëpaskohe.

2.2. PARIMET UDHËHEQËSE TË PUNËS SË ZRRUM

Parimet me të cilat udhëhiqet ZRRUM në punën e vet, për ti përmbushur misionin dhe synimet strategjike, janë:

- **Pavarësia:** Ekzekutimi me profesionalizëm por në mënyrë të pavarur i mandatit rregullator dhe përgjegjësi ligjore në interes qytetarëve të Kosovës;
- **Balancimi:** Përcaktimi i tarifave të balancuara të shërbimit të cilat u mundësojnë kompanive të licencuara të ujësjellësit dhe mbeturinave që të ofrojnë shërbimet në përputhje me standardet dhe kërkesat relevante, por të cilat poashtu marrin parasysh mundësitë paguese të popullatës.
- **Objektiviteti:** Monitorimi efektiv si dhe vlerësimi objektiv dhe transparent i punës së kompanive të licencuara duke bërë krahasime të duhura në baza vjetore për performancën e tyre;
- **Mbrojtja e Interesave të Konsumatorëve:** Trajtimi i kontesteve dhe ankesave të konsumatorëve në mënyrë efektive dhe të drejtë dhe duke involvuar kompanitë e licencuara në këtë proces;
- **Konsultimi:** Konsultimi me palët e interesit për të siguruar njohuri për pikëpamjet dhe prioritetet e tyre përmes shkëmbimit të informatave, memorandumëve të bashkëpunimit, mbajtjes së workshopeve të hapura, publikimit të raporteve relevante në web-faqen e vet, dhe përmes shtatë Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve. Jo më pak e rëndësishme është edhe ofrimi i këshillave Qeverisë për hartimin dhe rishikimin e politikave;
- **Transparenca:** Publikimi i informatave në mënyrë të hapur dhe transparente për tu mundësuar të gjitha palëve të interesit që të kuptojnë dhe participojnë në vendimet rregullatore të cilat i merr ZRRUM-i;
- **Bashkëpunimi:** Bashkëpunimi me të gjitha palët e interesit dhe në veqanti me rregullatorët tjerë të sektorit të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave në Kosovë (siq janë MMPH dhe IKSHPK) për tu siguruar se përgjegjësitë e palëve të ndryshme janë të përkufizuara qartë. Poashtu, ky parim i referohet edhe bashkëpunimit me rregullatorët tjerë ekonomik të shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave në regjion dhe në Europë me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe aplikimit të praktikave më të mira;
- **Mos-diskriminimi:** Sigurimi se tarifat e shërbimit me të cilat ngarkohen konsumatorët janë të drejta dhe nuk bëjnë diskriminim apo demonstrojnë preferenca për cilëndo kategori të konsumatorëve.

2.3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ZRRUM

Në përputhje me Rregulloren 2004/49 dhe Ligjin Nr. 03/L-086, ZRRUM udhëhiqet nga Drejtori dhe Zv. Drejtori si persona përgjegjës për funksionimin e Zyrës si dhe për marrjen e vendimeve rregullatore.


Me qëllim të operimit më eficient, efektiv dhe me kohë, ZRRUM ka aprovuar strukturën organizative të organizimit sipas të cilës departamentet e ZRRUM i përgjigjen direkt Drejtorit të ZRRUM-it.

ZRRUM përbëhet nga katër departamente, tri prej të cilave janë përgjegjëse për aktivitetet rregullatore dhe një departament ofron mbështetje për punën e Zyrës. Departamentet përgjegjëse për aktivitetin rregullator janë: Seksioni i Tarifave dhe Financave Rregullatore, Seksioni i Performansës, dhe Seksioni për Ligj dhe Licenca,

ndërkaq përgjegjës për mbështetjen veprimtarisë rregullatore të ZRRUM-it është Seksioni për Administratë dhe Financa.

Struktura organizative e ZRRUM është dhënë në **Figurën 1** në vijim:

Figura 1: Organogrami i ZRRUM



2.4. DEPARTAMENTET E ZRRUM

(i) Seksioni i Tarifave dhe Financave Rregullatore

Seksioni i Tarifave dhe Financave Rregullatore i ofron mbështetje të nevojshme Drejtorit të ZRRUM-it në përcaktimin e tarifave të shërbimit për ofruesit e licencuar të shërbimeve. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të këtij Seksioni përfshijnë:

- zhvillimin e metodologjisë dhe modeleve për llogaritjen tarifave të shërbimit;
- zhvillimin e praktikave dhe procedurave për aplikimin dhe shqyrtim të aplikacioneve për tarifa të shërbimit;
- udhëheqjen e procesit tarifar në frymën dispozitave ligjore në fuqi;
- shqyrtimin dhe evaluimin e të dhënave financiare nga raportet e kompanive të licencuara;
- auditimin e të dhënave financiare të kompanive të licencuara, dhe mbështetjen në hartimin e legjislacionit sekondar të ZRRUM-it.

(ii) Seksioni i Monitorimit të Performansës

Roli i Seksionit të Monitorimit të Performansës është që të organizojë sistemin e raportimit të kompanive të licencuara të ZRRUM-it dhe të përkujdeset për funksionimin e këtij sistemi. Në mënyrë të veçantë ky Seksion ka përgjegjësi për analizimin dhe vlerësimin e të dhënave të raportuara dhe përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore lidhur me performansën operative dhe financiare të ofruesve të licencuar të shërbimit.

Poashtu, në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi të Seksionit të Monitorimit të Performansës përfshihen edhe aspektet që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj konsumatorëve (bashkëpunimi me dhe mbështetja e punës së Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve, shqyrtimi i aplikacioneve lidhur me shqyçjet kolektive, vlerësimi i përmbushjes së standardeve të shërbimit etj.).

(iii) Seksioni për Ligj dhe Licencim

Seksioni për Ligj dhe Licencim i ofron mbështetje të nevojshme ligjore Drejtorit dhe stafit të ZRRUM-it në lidhje me aktivitetet e ZRRUM-it dhe përfaqëson Zyrën në të gjitha seancat administrative dhe gjyqësore para autoriteteve administrative, instancave të arbitrit, dhe gjykatave të Kosovës.

Ky Seksion poashtu është përgjegjës për përgatitjen dhe hartimin e praktikave dhe procedurave të licencimit si dhe udhëheqë të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me procesin e licencimit të kompanive që janë nën mandatin rregullator të ZRRUM.

Seksioni për Ligj dhe Licencim është përgjigjëse për hartimin dhe amendamentimin e legjislacionit sekondar si dhe akteve tjera përcjellëse procedurale që kanë të bëjnë me kodifikimin e aktivitete të ZRRUM-it

(iv) Seksioni i Administratës dhe Financave të ZRRUM

Seksioni i Administratës dhe Financave është përgjegjës për funksionimin administrativ dhe financiar të ZRRUM-it. Ky Seksion ofron mbështetje administrative,

gjuhësore, të menaxhimit të të dhënave, dhe të mbikqyrjes së financave të brendshme për Drejtorin dhe stafin e ZRRUM-it.

Poashtu ky Seksion menaxhon prokurimin, procesin e buxhetimit, resurset njerëzore, dhe aktivitetet tjera që kanë të bëjnë me objektin administrativ dhe automjetet e ZRRUM-it.

3. Aktivitetet Rregullatore të ZRRUM

3.1. LICENCIMI

Në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar me Rregulloren e UNMIK 2004/49 dhe me Ligjin Nr. 03/L-086 që ka amendamentuar këtë Rregullore, ZRRUM ka licencuar kompanitë publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, shërbimet e furnizimit të ujit me shumicë, si dhe shërbimet e grumbullimit të mbeturinave, Rrjedhimisht, gjatë vitit 2009 ZRRUM ka licencuar 15 kompani publike që ofrojnë shërbimet e përmendura:

(i) Kompanitë e Licencuara për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit

Në pajtim me përgjegjësitë e përcaktuara me ligj dhe duke u bazuar në procedurat dhe rregullat e përcaktuara me legjislacionin sekundar, ZRRUM ka licencuar kompanitë regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit si vijon:

1. **KRU “Prishtina” Sh. A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliqi, Podujevë, Lipjan, Shtimje, dhe Drenas;
2. **KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Prizren, Malishevë, Suharekë, dhe Dragash;
3. **KRU “Hidrodrini” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe komuna e Deçanit¹;
4. **KRU “Mitrovica” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Skënderaj dhe Vushtri;
5. **KRU “Hidrosistemi Radoniqi” Sh.A.**, që ofron shërbimet në komunat: Gjakovë, Rahovec dhe Prizren;

¹ Komuna e Deçanit ka qenë pjesë e zonës së shërbimit të KRU “Hidrodrini”, derisa me një vendim të Kuvendit Komunal i Deçanit të vitit 2007 ka vendosur të mos jetë pjesë e kompanisë regjionale “Hidrodrini” dhe ka themeluar ndërmarrjen komunale të ujësjellësit. Ky vendim i KK Deçan konsiderohet nga ZRRUM joligjor dhe është në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike. Megjithatë situata e krijuar kërkon angazhimin e institucioneve kompetente qeveritare për abrogimin e vendimit të KK Deçan dhe kthimin e kësaj komune nën autoritetin e KRU “Hidrodrini”.

6. KRU “Hidromorava” Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë, dhe Viti;

7. KRU “Bifurkacioni” Sh.A²., që ofron shërbimet në komunat: Ferizaj dhe Kaçanik.

Ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit që kanë ekzistuar në komunat me popullatë shumicë serbe (Shtërpçë, Novobërdë, Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) kanë mbetur jashtë proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit dhe rrejdhisht kanë mbetur jashtë procesit rregullator që e zbaton ZRRUM.

Licencat e këtyre shtatë kompanive regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit janë në fuqi deri më 31 tetor 2012.

(ii) Kompania e Licencuara për Furnizim të Ujit me Shumicë

Furnizimi i ujit me shumicë me Rregulloren 2004/49 është përkufizuar si furnizimi i ujit të papërpunuar për ofruesit e shërbimeve të ujit dhe ujërave të zeza.

Kompania e vetme e licencuar që ofron ujë me shumicë është:

1. “Ibër-Lepenci” Sh.A. e cila furnizon ujë me shumicë për KRU “Mitrovica” Sh.A. dhe KRU “Prishtina” Sh.A.

Licenca e “Ibër –Lepencit” është valide deri më 31 tetor 2012.

(iii) Kompanitë e Licencuara për Shërbimie e Grumbullimit të Mbeturinave

1. KRM “Pastrimi” Sh.A. që ofron shërbimet për komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Drenas, Lipjan, Podujevë, ..

2. KRM “Ekoregjioni” Sh.A. që ofron shërbimet në komunat: Prizren, Suharekë, Malishevë, Rahovec dhe Shar;

3. KRM “Ambienti” Sh.A. që ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, dhe Deçan³;

4. KRM “Uniteti” Sh.A. që ofron shërbimet e veta në komunat: Mitrovicë, Skënderaj dhe Vushtri;

5. KRM “Çabрати” Sh.A. që ofron shërbimet në komunat: Gjakovë;

6. KRM “Higjiena” Sh.A. që ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë, Viti ⁴ , Novo Bërd, Ranillug dhe Klokot;

7. KRM “Pastërtia” Sh.A. që ofron shërbimet në komunat: Ferizaj, Shtime dhe Kaçanik.

² KRU “Bifurkacioni” Sh.A., ka mbetur kompania e vetme regjionale e ujësjellësit dhe kanalizimit (me përjashtim të komunave me popullatë shumicë serbe të cilat nuk janë përfshirë fare në procesin e restrukturimit dhe korporatizimit) që është klasifikuar si ndërmarrje publike lokale në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Kjo ka ndodhë duke u bazuar në parimin që duhet të ofrohen shërbimet në 3 ose më tepër komuna për të qenë ndërmarrje qendrore publike.

³ Situata e njëjtë sikurse tek shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit është edhe tek shërbimet e grumbullimit të mbeturinave sa i përket komunës së Deçanit.

⁴ Kuvendi Komunal i Vitisë ka marrë poashtu vendim (në vitin 2008) që most ë jetë pjesë e KRM “Higjiena” dhe ka krijuar ndërmarrjen e veçantë për shërbimet e mbeturinave, që poashtu bie në kundërshtim me Ligjin për Ndërmarrjet Publike.

Licencat e kompanive regjionale të mbeturinave janë valide deri më 31 nëntor 2010.

Në vijim, janë paraqitur zonat e shërbimit të kompanive regjionale të ujit (Figura 1) dhe të kompanive të mbeturinave (Figura 2).

Figura 2: Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Ujësjetllësit dhe Kanalizimit



RWaterC Prishtina	RWaterC Hidroregjioni Jugor	RWaterC Hidrodrini	RWaterC Ujësjetllësi Regional	RWaterC Radoniqi	RWaterC Bifurkacioni	RWaterC Hidromorava	Municipalities that are not provided with water service
-Prishtina -Podujeva -Fushë Kosova -Obiliqi -Lipjani -Shtimja -Glogovci	-Prizreni -Suhareka -Malisheva -Dragashi	-Peja -Istogu -Klina -Juniku	-Mitrovica -Skenderaj -Vushtria	-Gjakova -Rahoveci	-Ferizaj -Kaçaniku	-Gjilani -Kamenica -Viti	-Novobërda -Zubin Potoku -Leposaviqi -Shtërpca -Deçani

Figura 3: Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Grumbullimit të Mbeturave



KRM Pastrimi	KRM Ekoregjioni	KRM Ambienti	KRM Uniteti	KRM Çabrat	KRM Pastërtia	KRM Higjiena	Komunitet jashtë shërbimeve nga KRM-të
-Prishtina -Podujeva -Fushë Kosova -Obiliqi -Lipjani -Glogovci	-Prizreni -Suhareka -Malisheva -Dragashi -Rahoveci	-Peja -Klina -Deçani	-Mitrovica -Skenderaj -Vushtria	-Gjakova	-Ferizaj -Kaçaniku -Shtimja	-Gjilani -Kamenica -Vitia	-Novobërda -Zubin Potoku -Leposaviqi -Shtërpca -Istogu

3.2. MONITORIMI I PERFORMANSËS

ZRRUM monitoron performansën e kompanive publike të licencuara të cilat ofrojnë shërbimet e ujit dhe mbeturinave. Monitorimi i performansës bëhet në bazë të raporteve të cilat i dorëzojnë këto ndërmarrje tek ZRRUM duke u bazuar në sistemin e raportimit të krijuar nga ZRRUM i quajtur OFCR/ROFK.

Përpos monitorimit, ZRRUM bën edhe vlerësimin e performansës së kompanive të ujit dhe mbeturinave, bazuar në Indikatorët Kyç të Performansës (IKP) dhe raporton publikisht për performancën e tyre në formën e Raportit Vjetor të Performansës. Me qëllim të verifikimit të saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara nga kompanitë e licencuara, ZRRUM bën auditimin e të dhënave dhe procedurave në bazë të të cilave gjenerohen të dhënat nga kompanitë. Procesi i auditimit kryhet gjatë periudhës janar-prill të vitit pasues, kështuqë të dhënat e raportuara për performancën e kompanive të ujit dhe mbeturinave për vitin 2009 janë duke u audituar aktualisht. Megjithatë, në vazhdim është dhënë në formë të përmbledhur performanca operative, financiare dhe e shërbimeve ndaj konsumatorëve për kompanitë publike që ofrojnë shërbimet e ujit dhe mbeturinave në bazë të licencës së lëshuar nga ZRRUM, sipas të dhënave të raportuara nga ato dhe të pa-audituar nga ZRRUM.

3.2.1. PERFORMANCA E KOMPANIVE REGJIONALE TË UJIT PËR VITIN 2009

Në vazhdim të këtij raporti është dhënë një pasqyrë shkurt e performancës së kompanive publike të cilat ofrojnë shërbimet e ujësjellësit dhe mbeturinave në Kosovë dhe ka për qëllim njoftimin e aktereve të ujit për gjendjen e kompanive në vitin 2009 krahasuar me 2008.

Në këtë raport është paraqitur performanca relative në nivel të sektorit si dhe performanca relative individuale për secilën kompani.

Raporti është përgatitur duke u bazuar në të dhënat e raportuara nga kompanitë e ujit në pajtim me obligimet e tyre raportuese. Poashtu duhet të keni parasysh se të dhënat e vitit 2008 janë të audituara prandaj edhe janë të besueshme, ndërsa të dhënat e vitit 2009 janë të dhëna të raportuara dhe ende të paudituar. Auditimi i tyre do të bëhet gjatë muajit Prill 2010.

Te kualiteti i ujit për vitin 2008 të dhënat janë siguruar nga IKSHPK ndërsa për vitin 2009 janë marrë nga raportet e kompanive.

PASQYRA E PËRGJITHSHME E SEKTORIT

Tabela në vijim paraqet performancën e sektorit të ujit, përmes treguesve kyç të performancës, gjatë periudhës 2008-2009.

Tabela 1. Performanca e përgjithshme e Sektorit

Treguesit	2009	2008	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	59%	56%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	78%	80%	Trend negativ
Shkalla e arkëtimit %	63%	65%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	0.98	1.04	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/m ³)	€0.11	€0.11	Trend i njëjtë
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	6.81	6.99	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	5	5	Trend i njëjtë
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	3%	3%	Trend i njëjtë

Në vitin 2009 krahasuar me 2008 sektori i ujit ka performuar më dobët në shumicën e treguesve kyç.

Shpenzimet Operative

Në përgjithësi shpenzimet operative kanë pasur një rritje në vitin 2009 në krahasim me 2008 për 4%, përderisa trendet e zhvillimit për secilën kategori të kostove nga shuma totale të kostove operative mund të vërehet në tabelën vijues (Tabela 2).

Tabela 2. Shpenzimet operative sipas kategorive.

Treguesit	2009	2008	prog/reg
Uji i blerë %	2%	2%	Trend i njëjtë
Pagat %	43%	52%	Trend pozitiv
Mirembajtja %	9%	11%	Trend negativ
Energjia %	22%	19%	Trend negativ
Derivatet %	2%	4%	Trend pozitiv
Kemikalet %	2%	3%	Trend pozitiv
Shpenzimet tjera %	4%	9%	Trend pozitiv

PERFORMANCA RELATIVE E KOMPANIVE TË UJIT

Performanca relative tregon krahasimin e performancës së secilës Kompani individuale të ujit në mes të periudhave, në këtë rast në mes të vitit 2009 dhe 2008.

Në vijim janë paraqitur trendet e zhvillimit të secilës Kompani.

KRU 'PRISHTINA', SH.A

Tabela në vijim paraqet performancën e kompanisë KRU 'Prishtina', sh.a. për vitin 2009 krahasuar me 2008.

Tabela 3. Performanca relative e KRU 'PRISHTINA', SH.A.

Treguesit	2009	2008	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	54%	46%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	80%	80%	Trend i njëjtë
Shkalla e arkëtimit %	65%	66%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	1.05	1.09	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/m ³)	€0.14	€0.14	Trend i njëjtë
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	5.83	5.99	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	5	8	Trend negativ
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	1.4%	0%	Trend negativ
Vazhdimësia e furnizimit me ujë (skan raportuar) ⁵	?*	?*	?

Në vitin 2009 krahasuar me 2008 KRU 'Prishtina', sh.a. ka treguar performancë më të dobët në treguesit kyç të performancës.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me 2008 Uji i Pafaturuar (%) është ngritur si rezultat i rritjes së dukshme të prodhimit të ujit dhe rënies së faturimit të ujit. Zvogëlimi i faturimit të ujit, përkundër rritjes së numrit të konsumatorëve dhe mbetjes stabile të Proporcionit të konsumatorëve me ujëmatës (%), mund të shpjegohet ose si kursim i ujit nga ana e konsumatorëve apo si parregullësi gjatë procesit të faturimit nga ana e kompanisë. Për më tepër, Uji i prodhuar për konsumatorë për muaj (m³) është ngritur në 44 m³ në vitin 2009 krahasuar me 43 m³ sa ishte në 2008; përderisa Uji i faturuar sipas konsumimit për konsumatorë për muaj (m³) ka rënë në 21 m³ në vitin 2009 nga 23 m³ sa ishte në vitin 2008.

Gjatë muajve në vijim ZRRUM planifikon të bëjë verifikimin e ujëmatësve individual në teren për të vërtetuar besueshmërinë e leximit të ujëmatësve nga ana e kompanisë.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me 2008 Shkalla e arkëtimit (%) ka rënë për 1%, kjo mund të jetë si pasojë e funksionimit jo aq efikas të sistemit të arkëtimit nga ana e kompanisë, nivelit jo të kënaqshëm të shërbimit (mungesa e ujit) ndaj konsumatorëve apo mundësisë së vogël për të paguar nga ana e një kategorie të konsumatorëve.

Norma e mbulesës së punës prej 1.05 tregon se kompania ka qenë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e arkëtuara. Në zvogëlimin e normës së mbulesës së punës prej viti-në-vit ka ndikuar rritja e shpenzimeve operative për €437,092 në 2009 krahasuar me 2008 edhe përkundër rritjes prej €229,252 të të hyrave të gatshme.

Në vitin 2009 krahasuar me 2008 Shpenzimet operative për m³ të ujit të prodhuar nuk kanë pësuar ndryshim.

Një progres të vogël kompania e ka shënuar te Efikasiteti i stafit.

⁵ Rregullatori ka kërkuar nga kompania KRU "Prishta" të raportoj për planin e furnizimeve dhe reduktimit të ujit

KRU 'HIDROREGJIONI JUGOR', SH.A.

Tabela në vijim paraqet performancën e kompanisë KRU 'Hidroregjioni Jugor', sh.a. në vitin 2009 krahasuar me 2008.

Tabela 4. Performanca relative e KRU 'HIDROREGJIONI JUGOR', SH.A.

Treguesit	2009	2008	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	55%	44%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	79%	90%	Trend negativ
Shkalla e arkëtimit %	62%	64%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	0.91	0.86	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m ³)	€0.12	€0.15	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	6.02	6.36	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	2	?	Trend pozitiv
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	3.5%	4.8%	Trend pozitiv
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	24	24	Trend i njëjtë

Në vitin 2009 krahasuar me 2008 KRU 'Hidroregjioni Jugor', sh.a. ka treguar performancë më të dobët në disa prej treguesve kyç të performancës.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me 2008 Uji i Pafaturuar (%) është ngritur si rezultat i rritjes së dukshme të prodhimit të ujit dhe rënies së faturimit të ujit. Zvogëlimi i faturimit të ujit, përkundër rritjes së numrit të konsumatorëve dhe zvogëlimit të proporcionit të konsumatorëve me ujëmatës (%), mund të shpjegohet më tepër si kursim i ujit nga ana e konsumatorëve pasi që Uji i faturuar sipas konsumimit për një konsumator për një muaj (m³) në vitin 2009 është 20 m³ përderisa në 2008 ka qenë 21 m³, në të njëjtën kohë nuk mund të përjashtohen edhe shkaqet tjera. Për të vërtetuar besueshmërinë e leximit të ujëmatësve nga ana e kompanisë, ZRRUM planifikon të bëjë verifikimin e ujëmatësve individual në teren gjatë muajve në vijim.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me 2008 Shkalla e arkëtimit (%) ka rënë për 2%, kjo mund të jetë si pasojë e funksionimit jo aq efikas të sistemit të arkëtimit nga ana e kompanisë, nivelit jo të kënaqshëm të shërbimit ndaj konsumatorëve apo mundësisë së vogël për të paguar nga ana e një kategorie të. Në vitin 2009 krahasuar me 2008 edhe përkundër ngritjes së Normës së mbulesës së punës prapë se prapë kjo kompani nuk ka qenë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e arkëtuara. Në ngritjen e Normës së mbulesës së punës prej viti-në-vit ka ndikuar rritja e vlerës së parave të gatshme prej €153,145 përkundër rritjes së lehtë të shpenzimeve operative.

Në vitin 2009 krahasuar me 2008 Shpenzimet operative për m³ të ujit të prodhuar kanë shënuar trend pozitiv.

Një progres të vogël kompania e ka shënuar edhe te Efikasiteti i stafit, kjo si rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve për 2,784.

KRU 'HIDRODRINI', SH.A.

Në tabelën në vijim është paraqitur performanca e kompanisë KRU 'Hidrodrini', sh.a. në vitin 2009 krahasuar me vitin 2008.

Tabela 5. Performanca relative e KRU 'HIDRODRINI', SH.A.

Treguesit	2009	2008	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	74%	75%	Trend pozitiv
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	87%	88%	Trend negativ
Shkalla e arkëtimit %	60%	66%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	1.03	1.27	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/m ³)	€0.05	€0.04	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	5.93	6.14	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons	5	5	Trend i njëjtë
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	5.3%	5.2%	Trend negativ
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	24	24	Trend i njëjtë

Në vitin 2009 krahasuar me 2008 KRU 'Hidrodrini', sh.a. ka treguar performancë më të dobët në disa prej treguesve kyç të performancës, përveç në Ujin e pafaturuar dhe Efikasitetin e stafit ku trendet kanë qenë progresive.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me 2008 kemi një përmirësim të vogël në Ujin e Pafaturuar (%), kjo ka ardhë si rezultat i zvogëlimit më të dukshëm të prodhimit të ujit kundrejt zvogëlimit më të vogël të faturimit të ujit. Zvogëlimi i faturimit të ujit, përkundër rritjes së numrit të konsumatorëve për 1,900 dhe zvogëlimit të Proporcionit të konsumatorëve me ujëmatës (%), mund të shpjegohet më tepër si kursim i ujit nga ana e konsumatorëve pasi që Uji i faturuar sipas konsumimit për një konsumatorë për një muaj (m³) në vitin 2009 është 22 m³ përderisa në 2008 ka qenë 24 m³. Përveç këtij shpjegimi nuk mund të përjashtohen edhe shkaqet tjera.

Edhe në këtë kompani do të vërtetohet besueshmëria e leximit të ujëmatësve nga ZRRUM.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me 2008 Shkalla e arkëtimit (%) ka rënë për 6%. Zvogëlimi i dukshëm prej 6% kërkon një analizë më të thellë të situatës në kompani.

Norma e mbulesës së punës prej 1.03 tregon se kompania ka qenë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e arkëtuara. Në zvogëlimin e Normës së mbulesës së punës prej viti-në-vit ka ndikuar rritja e shpenzimeve operative për €162,211 dhe zvogëlimi prej €107,704 i të hyrave të gatshme.

Në vitin 2009 krahasuar me 2008 Shpenzimet operative për m³ të ujit të prodhuar kanë shënuar një ngritje të vogël, megjithatë kompania ende mbetet lider në këtë tregues në krahasim me kompanitë tjera.

Një progres të vogël kompania e ka shënuar te Efikasiteti i stafit.

KRU 'MITROVICA', SH.A.

Tabela në vijim paraqet performancën e kompanisë KRU 'Mitrovica', sh.a. për vitin 2009 krahasuar me 2008.

Tabela 6. Performanca relative e KRU 'MITROVICA',SH.A.

Treguesit	2009	2008	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	51%	54%	Trend pozitiv
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	49%	47%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit %	51%	53%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	0.70	0.95	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/m3)	€0.10	€0.11	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	10.16	10.39	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	5.5	?	Trend pozitiv
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	2.6%	2.6%	Trend i njëjtë
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	18	18	Trend i njëjtë

* Kjo nuk përfshinë të hyrat nga pjesa veriore e Mitrovicës

Në vitin 2009 krahasuar me 2008, KRU 'Mitrovica', sh.a., ka treguar performancë më të mirë sa i përket disa treguesve kyç.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me 2008 kemi një përmirësim në Ujin e Pafaturuar (%), në të cilën ka ndikuar rritja e dukshme e faturimit të ujit për 734,436 m3 ose 9% përkundër rritjes së lehtë prej 3% të ujit të prodhuar. Kjo është përcjellur me një rritje prej 341 të numrit të konsumatorëve.

Në vitin 2009 krahasuar me 2008 Shkalla e arkëtimit (%) ka rënë për 2%.

Norma e mbulesës së punës prej 0.70 tregon se kompania ka qëndruar dobët financiarisht dhe nuk ka qenë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat vetanake. Për këtë shkak, gjatë vitit 2009, kompania ka pranuar rreth €590,000 subvencione nga Qeveria.

Në vitin 2009 krahasuar me 2008 Shpenzimet operative për m3 të ujit të prodhuar kanë pësuar një rënie të lehtë.

Një progres të vogël kompania e ka shënuar te Efikasiteti i stafit si rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve përkundër rritjes së numrit të punëtorëve.

KRU 'RADONIQI', SH.A.

Tabela në vijim paraqet performancën e kompanisë KRU 'Radoniqi', sh.a. në vitin 2009 krahasuar me 2008.

Tabela 7. Performanca relative e KRU 'HS RADONIQI', sh.a.

Treguesit	2009	2008	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	59%	62%	Trend pozitiv
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	94%	94%	Trend i njëjtë
Shkalla e arkëtimit %	69%	71%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	1.02	1.07	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/m3)	€0.12	€0.10	Trend negativ
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	8.06	8.06	Trend i njëjtë
Ankesat për '000 kons.	5	5	Trend i njëjtë
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	0%	0%	Trend i njëjtë
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	24	24	Trend i njëjtë

Në vitin 2009 krahasuar me 2008 KRU 'Radoniqi', sh.a., përveç se ka treguar trend pozitiv në Ujin e pafaturuar, te treguesit tjerë trendet kanë qenë negative ose stabile.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me 2008 kemi një përmirësim të vogël në Ujin e Pafaturuar (%), kjo ka ardhë si rezultat i zvogëlimit më të dukshëm të prodhimit të ujit për 1,885,487 m³ kundrejt zvogëlimit më të vogël të faturimit të ujit për 216,456 m³. Zvogëlimi i prodhimit dhe faturimit të ujit, përkundër rritjes së numrit të konsumatorëve për 553 dhe mbetjes stabile të Proporcionit të konsumatorëve me ujëmatës (%), mund të shpjegohet më tepër si kursim i ujit nga ana e konsumatorëve duke ditur që Uji i faturuar sipas konsumit të matur në m³ për një konsumatorë për një muaj në vitin 2009 është 18 m³ përderisa në 2008 ka qenë 19 m³. Përveç këtij shpjegimi nuk mund të përjashtohen edhe shkaqet tjera. Edhe në këtë kompani do të vërtetohet besueshmëria e leximit të ujëmatësve nga ZRRUM.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me 2008 Shkalla e arkëtimit (%) ka rënë për 2%.

Norma e mbulesës së punës prej 1.02 tregon se kompania ka qenë financiarisht në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e arkëtuara. Si e tillë, Norma e mbulesës së punës, prej viti-në-vit, ka pësuar rënie si pasojë e rritjes së shpenzimeve operative prej €70,560 dhe zvogëlimit të të ardhurave për €16,846.

Rritja e shpenzimeve operative, e sidomos atyre direkte, përkundër zvogëlimit të dukshëm të prodhimit të ujit, nuk mund të shpjegohet lehtë! Si rezultat, Shpenzimet operative për m³ të ujit të prodhuar kanë shënuar një ngritje prej viti-në vit.

Efikasiteti i stafit ka mbetë i pandryshuar.

KRU 'BIFURKACIONI', SH.A.

Tabela në vijim paraqet performancën e kompanisë KRU 'Bifurkacioni', sh.a. në vitin 2009 krahasuar me 2008.

Tabela 8. Performanca relative e KRU 'BIFURKACIONI', SH.A.

Treguesit	2009	2008	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	57%	48%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	63%	60%	Trend pozitiv
Shkalla e arkëtimit %	60%	57%	Trend pozitiv
Norma e mbulimit të punës	1.18	0.89	Trend pozitiv
Kostoja për njësi (€/m ³)	€0.11	€0.18	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	6.63	6.82	Trend pozitiv
Ankesat për '000 kons.	3	?	Trend pozitiv
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	3%	8.3%	Trend pozitiv
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	19	16	Trend pozitiv

Në vitin 2009 krahasuar me 2008, KRU 'Bifurkacioni', sh.a. ka treguar performancë më të mirë te shumica e treguesve kyç, përveç ujit të pafaturuar ku trendi ka qenë negativ.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me 2008 Uji i Pafaturuar (%) është ngritur kryesisht si rezultat i rritjes së dukshme të prodhimit të ujit përkundër ngritjes së lehtë të faturimit të ujit.

Përkundër rritjes prej 3% pikë të Proporcionit të konsumatorëve me ujëmatës (%), Konsumimi i matur (%) ka mbetur i njëjtë në 65%. Kjo dukuri mund të shpjegohet më tepër si kursim i ujit nga ana e konsumatorëve, duke mos përjashtuar edhe mundësinë e paraqitjes së parregullësive gjatë faturimit. Në fakt, kjo është vërtetuar gjatë verifikimit të ujëmatësve individual që është bërë nga ana e ZRRUM në regjionin ku

kryen shërbime kompania. Si rezultat i këtij verifikimi ka dalë se në 28% të rasteve të inspektuara faturimi bëhet duke u bazuar në harxhimet e vlerësuara, ndërsa 6% janë identifikuar si raste me faturim të parregullt.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me 2008 Shkalla e arkëtimit (%) është ngritur për 3%, kjo si rezultat i rritjes më të dukshme të arkëtimit kundrejt rritjes së faturimit.

Norma e mbulesës së punës prej 1.18 tregon se kompania, në vitin 2009, ka qenë në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e arkëtuara. Në rritjen e këtij treguesi ka ndikuar, përveç rritjes së të hyrave edhe zvogëlimi i shpenzimeve operative.

Në vitin 2009 krahasuar me 2008 Shpenzimet operative për m³ të ujit të prodhuar kanë shënuar rënie prej €162,504.

Një progres të vogël kompania e ka shënuar te Efikasiteti i stafit.

KRU 'HIDROMORAVA', SH.A.

Tabela në vijim paraqet performancën e kompanisë KRU 'Hidromorava', sh.a. në vitin 2009 krahasuar me 2008.

Tabela 9. Performanca relative e KRU 'HIDROMORAVA', SH.A.

Treguesit	2009	2008	prog/reg
Uji i pa-faturuar %	57%	50%	Trend negativ
Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës %	78%	81%	Trend negativ
Shkalla e arkëtimit %	63%	77%	Trend negativ
Norma e mbulimit të punës	0.89	0.94	Trend negativ
Kostoja për njësi (€/m ³)	€0.15	€0.18	Trend pozitiv
Efikasiteti i stafit ('000 kons)	8.79	8.74	Trend negativ
Ankesat për '000 kons.	10	11.6	Trend i njëjtë
Testet e dështuara të kualitetit të ujit %	?	0%	?
Vazhdimësia e furnizimit me ujë	?	?	?

Në vitin 2009 krahasuar me 2008, KRU 'Hidromorava', sh.a. në përgjithësi ka treguar performancë më të dobët.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me 2008 Uji i Pafaturuar (%) është ngritur si rezultat i rritjes së dukshme të prodhimit të ujit përkundër një ngritjeje të vogël të faturimit të ujit. Shkaqet e rritjes jo paralele të ujit të faturuar kundrejt ujit të prodhuar duhet të hulumtohen më thellë. ZRRUM vlerëson se kjo është e lidhur drejtëpërsëdrejti me parregullësitë në faturimin e konsumatorëve me theks në leximin e ujëmatësve. Kjo është dëshmuar edhe gjatë inspektimit të ujëmatësve individual në teren.

Gjatë vitit 2009 krahasuar me 2008 Shkalla e arkëtimit (%) ka rënë për 14%! Zvogëlimi aq i dukshëm i këtij treguesi kërkon një analizë më të thellë të situatës në kompani.

Norma e mbulesës së punës prej 0.89 tregon se kompania nuk ka qenë financiarisht në gjendje t'i mbulojë shpenzimet operative me të hyrat e arkëtuara. Në zvogëlimin e normës së mbulesës së punës prej viti në vit ka ndikuar zvogëlimi i të hyrave të gatshme për €19,575 (ose 2%) dhe zvogëlimi i të hyrave tjera operative, përkundër zvogëlimit prej €27,636 të shpenzimeve operative.

Në vitin 2009 krahasuar me 2008 Shpenzimet operative për m³ të ujit të prodhuar kanë shënuar një rënie, kjo kryesisht si rezultat i rritjes së prodhimit të ujit ku shpenzimet fikse mbesin konstante.

Efikasiteti i stafit është ngritur (trend negativ) si rezultat i rritjes shumë të lartë të numrit të stafit prej 10, përkundër rritjes së numrit të konsumatorëve.

3.2.2 PERFORMANCA E SEKTORIT TE MBETURINAVE

(i) Shërbimet e Grumbullimit të Mbeturinave

Në 2009 krahasuar me 2008, performansa e shtatë kompanive regjionale të cilat ofrojnë shërbime të grumbullimit të mbeturinave, ka shënuar një trend negativ në shumë tregues financiar të performancës duke përfshirë shkallën e arkëtimit e cila drejtpërdrejt ndikon në qëndrueshmërinë financiare të këtyre kompanive, përderisa tek disa tregues operativ kemi një trend në përmirësim.

Vlerësimi është bërë duke u bazuar në treguesit kryesor të performancës, të përlogaritur nga të dhënat që i kanë raportuar kompanitë. Të dhënat për vitin 2008 kanë qenë të audituar përderisa për vitin 2009 ato pritet të auditohen gjatë muajit prill.

Edhe në vitin 2009, të gjitha kompanitë kanë qenë nën kufirin e qëndrueshmërisë financiare, kryesisht si rezultat i shkallës së ulët të arkëtimit të faturave për shërbimet e ofruara.

Efiçenca e Stafit

Përderisa në vitin 2008 për 1000 konsumator kane shërbyer 9.24 puntorë kjo normë në vitin 2009 është përmisuar dhe në vitin 2009 ajo ishte 9.08 për 1000 kons. që d.th. kemi ulje të efiçencës në shërbime ndaj konsumatorve e cila vrehet edhe tek grumbullimi i mbeturinave.

Në përgjithësi, mesatarja e mbeturinave të mbledhura për punëtor në vitin 2009 ka qenë 176,20 ton, që është për 6 ton më e lartë se në vitin 2008.

Tabela 10: Efiçenca e Stafit të Kompanive Regjionale të Grumbullimit të Mbeturinave

Efikasiteti i stafit			prog/reg
	2008	2009	
KRM "Higjiena" Sh.A	8.03	7.05	Trend pozitiv
KRM "Ambienti" Sh.A	7.59	7.35	Trend pozitiv
KRM "Pastertia" Sh.A	8.98	8.42	Trend pozitiv
KRM "Pastrimi" Sh.A	9.07	8.98	Trend pozitiv
KRM "Eco-Regjioni" Sh.A	8.90	9.08	Trend negativ
Mesatarja e sektorit	9.28	9.04	Trend negativ
KRM "Çabрати" Sh.A	10.12	10.51	Trend negativ
KRM "Uniteti" Sh.A	15.28	14.29	Trend pozitiv

Shkalla e Arkëtimit

Në përgjithësi në nivel të sektorit të grumbullimit të mbeturinave, shkalla e arkëtimit në vitin 2009 është 53% dhe ka trend të uljes nga viti 2008 për 8%. Nga tabela vërehet se uljen më të lartë të arkëtimit e ka shënuar KRM 'Higjiena dhe KRM 'Pastrimi'.

Nivel i shkallës së arkëtimit ka shënuar zbritje te kategoria e konsumatorve komercial-industrial perderisa te amvisnia dhe instuticionet ka mbetur e njejtë edhe këtë vit.

Shkalla e arkëtimit prej 53% është në nivel të pa akceptueshem, dhe në këtë mënyrë ju pamundson kompanive të mbulojnë koston operative, padyshim efektet e saja do të reflektohen edhe në nivelin e ulët të mirëmbajtjes së aseteve dhe përkeqësimin e nivelit të shërbimeve nga kompanitë publike.

Tabela 11: Shkalla e Arkëtimit të Kompanive Regjionale të Grumbullimit të Mbeturinave

Shkalla e arketimit %			prog/reg
	2008	2009	
KRM "Pastertia" Sh.A	69%	69%	Trend i njëjtë
KRM "Çabрати" Sh.A	62%	61%	Trend negativ
KRM "Eco-Regjioni" Sh.A	60%	55%	Trend negativ
KRM "Uniteti" Sh.A	57%	55%	Trend negativ
KRM "Ambienti" Sh.A	61%	53%	Trend negativ
Mesatarja e sektorit	61%	53%	Trend negativ
KRM "Pastrimi" Sh.A	58%	51%	Trend negativ
KRM "Higjiena" Sh.A	63%	42%	Trend negativ

Norma e Mbulimit të Punës dhe Kostot Njësi

Norma e mbulimit të punës në vitin 2009 ka shënuar nivelin 0.88 dhe në krahasim me vitin 2008 ka shënuar ngritje vetëm për 1 %, konsiderohet se është në nivel të ultë dhe për pasoj ka pamundësin e kompanive për të mbuluar shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes.

Tabela 12: Norma e Mbulimit të Punës

Norma e mbuleses se punes			prog/reg
	2008	2009	
KRM "Pastertia" Sh.A	0.88	0.98	Trend pozitiv
KRM "Çabрати" Sh.A	0.91	0.98	Trend pozitiv
KRM "Higjiena" Sh.A	0.70	0.96	Trend pozitiv
KRM "Pastrimi" Sh.A	1.00	0.92	Trend negativ
Mesatarja e sektorit	0.87	0.88	Trend pozitiv
KRM "Uniteti" Sh.A	0.77	0.82	Trend pozitiv
KRM "Ambienti" Sh.A	1.00	0.84	Trend negativ
KRM "Eco-Regjioni" Sh.A	0.74	0.75	Trend pozitiv

Në vitin 2009, kostoja për njësi ka qenë €32.21, ku krahasuar me 2008, në nivel të sektorit, është treguar zvogëlim prej €2.00 për njësi (ton i mbeturinave të grumbulluara).

Pjesëmarrja e secilës kategori të kostove në shumën totale të kostove operative si mesatare e kompanive regjionale të mbeturinave mund të shihet në Tab.13.

Tabela13: Struktura e Kostove Operative të Kompanive Regjionale të Grumbullimit të Mbeturinave

Shpenzimet operative për sektorin sipas kategorive			prog/reg
	2008	2009	
Përqindja e shpenzimeve të stafit	54%	59%	Trend negativ
Përqindja e shpenzimeve të lëndeve djegëse	18%	15%	Trend pozitiv
Përqindja e shpenzimeve të deponimit	11%	11%	Trend i njëjtë
Përqindja e shpenzimeve M&R	5%	5%	Trend i njëjtë
Shpenzime te tjera	12%	10%	Trend Pozitiv

Mbeturinat e Deponuara

Gjatë vitit 2009, në mesatare të sektorit, rreth 87% e mbeturinave të grumbulluara janë deponuar në deponitë e licencuara, d.m.th për 4% më tepër se në vitin 2008, ndërsa pjesa tjetër e mbetur hedhen në fushë hedhurinat komunale. Edhe mëtej regjioni i Gjakovës mbetet pa deponi të licencuar, kështu që Çabrat, Gjakovë të tërë sasinë e mbeturinave e ka hedhur në deponitë e pa licencuara, të cilat janë jashtë çdo standardi ambiental.

Tabela13: Mbeturinat e deponuara në deponitë e licencuara

Përqindja e deponimit të mbeturinave në deponinë e licencuar			prog/reg
	2008	2009	
KRM "Uniteti" Sh.A	100%	100%	Trend i njëjtë
KRM "Higjiena" Sh.A	100%	100%	Trend i njëjtë
KRM "Eco-Regjioni" Sh.A	89%	100%	Trend pozitiv
KRM "Pastertia" Sh.A	95%	93%	Trend negativ
KRM "Pastrimi" Sh.A	84%	90%	Trend pozitiv
Mesatarja e sektorit	83%	87%	Trend pozitiv
KRM "Ambienti" Sh.A	83%	85%	Trend negativ
KRM "Çabrat" Sh.A	0%	0%	Trend i njëjtë

(ii) Shërbimet e Deponimit të Mbeturinave

Menaxhimi i deponive sanitare në Kosovë bëhet nga Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës-KMDK Sh.A. Shumica e konsumatorëve të KMDK (por jo të gjithë) janë kompanitë regjionale të grumbullimit të mbeturinave për zonat e shërbimit në Prishtinë, Gjiilan, Ferizaj, Podujevë dhe Prizren dhe një numër i operatorëve privat ndërkombëtar dhe vendor.

Dy nga kompanitë e grumbullimit të mbeturinave, KRM 'Uniteti' Mitrovicë si dhe KRM 'Ambienti' Pejë janë të licencuara për menaxhimin e deponive regjionale në këto dy qytete d.m.th. ato menaxhohen nga vete keto kompani. Ndërkaq, KRM 'Çabrat' Gjakovë vazhdon të deponojë mbeturinat në deponi të palicencuara.

Vlerësimi i performancës së KMDK është bërë duke u bazuar në treguesit kryesor të performancës, të përlogaritur nga të dhënat e pranuar nga kjo kompani.

Gjatë vitit 2009 rreth 213.219 ton mbeturina janë deponuar në tërë deponitë e menaxhuara nga KMDK, sasi kjo që është për 8% më e madhe se sa në vitin 2008.

Me përfundimin e vitit 2009 KMDK ka ndërmarrë një organizim të mbrendshëm me qëllim të përmirësimit të performancës së saj operative.

Organizim i Mbrendeshëm konsiston në Largimin e operatorve privat nga operimi në deponi, si dhe nënshkrimi i marrëveshjeve me disa nga kompanitë regjionale të mbeturinave në lidhje me arkëtimin e faturave për mbeturina e deponuara.

3.3. TARIFAT E SHËRBIMIT

3.3.1. Tarifat e Shërbimeve të Ujësjellësit dhe Kanalizimit

Në pajtim me mandatin ligjor që ka, ZRRUM gjatë vitit 2008 ka zhvilluar procesin tarifor për aprovimin e tarifave për shërbimet e ujësjellësit dhe kanalizimit për shtatë kompanitë regjionale të licencuara që ofrojnë këto shërbime. Si rezultat i këtij procesi janë aprovuar tarifat e reja të shërbimit të cilat kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2009 dhe janë të aplikueshme për periudhën e ardhshme trevjeçare (2009, 2010 dhe 2011).

Ndërsa si proces të veçantë gjatë vitit 2009 ka përcaktuar edhe tri tarifa tjera të ujit me shumicë.

Gjatë vitit 2009 ZRRUM ka monitoruar efektet e tarifave të reja dhe si rezultat i këtij monitorimi i ka përgatitur dhe publikuar 2 raporte periodike.

(i) Metodologjia e Përcaktimit të Tarifave

E veçanta e këtij procesi është aplikimi i një metodologjie më të avancuar në krahasim me vitet e mëparshme, metodologji kjo e cila është zhvilluar në bashkëpunim me ekspertët ndërkombëtar të cilët e kanë mbështetur ZRRUM në kuadër të projektit të AER-it. Kjo metodologji është diskutuar dhe sqaruar për kompanitë e ujësjellësit dhe kanalizimit (në 3 punëtori dhe shumë takime tjera individuale që janë mbajtur për këtë qëllim). Pasi tarifat e këtij cikli rregullatorë janë tri vjeçare – afatmesme, në vijim po përshkruajmë metodologjinë dhe angazhimet shtesë për të monitoruar, analizuar dhe vlerësuar efektet që do të prodhojnë tarifatat në fjalë. Karakteristikat kryesore të kësaj metodologjie tarifore janë:

- Aprovimi i tarifave shumëvjeçare (3 vjeçare) për dallim nga proceset e mëparshme kur tarifatat janë aprovuar për afat 1 vjeçar;
- Marrja parasysh e llogaritjes së shkallës së amortizimit për asetet jo-infrastrukturore;
- Aplikimi i Normës së Kthimit në Kapital sipas përvojave të vendeve me ekonomi të tregut të hapur dhe atyre të BE-së;
- Aplikimi i Kontabilitetit Rregullator;
- Përcaktimin e ndarë të kostove për shërbimet e ujësjellësit nga kostot për shërbimet e kanalizimit.
- Monitorimi i të dhënave periodike për të gjitha KRU-t gjatë vitit 2009 për të analizuar dhe vlerësuar efektet e dalës nga tarifatat e reja të filluara për aplikim që nga 1 janari i vitit 2009;
- Publikimi i raporteve dhe dokumenteve të tjera të ndërlidhura me procesin tariforë për të parë efektet e tarifave të tilla dhe informimi i palëve të ndërlidhura me të njëjtat;

- Ndërmarrjen e veprimeve të caktuara për të asistuar te kompanitë për të përmirësuar performancën e tyre.

(ii) Tarifat e Aprovuara

Tarifat e reja kanë shënuar një ngritje të përmbajtur të tyre në krahasim me tarifën e mëparshme. Kjo ngritje e tarifave është vlerësuar si absolutisht e domosdoshme për t'iu mundësuar kompanive gjenerimin e të hyrave të nevojshme për mbulimin e kostove të tyre dhe ngritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve. Po ashtu, kjo ngritje e tarifave është e para në tri vitet fundit (tarifat e ujit janë ngritur për herë të fundit në fillim të vitit 2006) edhe pse në ndërkohë janë ngritur çmimet e mallrave tjera dhe tarifën e energjisë elektrike të cilat kanë ndikim të drejtë për drejtë dhe të konsiderueshëm në koston e ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Parimi bazë i vendosur për përcaktim të tarifave të ndryshme gjatë viteve 2009, 2010 dhe 2011 ka qenë ai ekonomik i cili është akorduar në marrëveshje me kompanitë. I njëjti është ndërlidhë me përmbushjen e çfaqeve operative dhe financiare vit pas viti për çdo kompani e të cilat kanë rezultuar me tarifa të ndryshme vjetore dhe regjionale.

Caqet e përcaktuara janë; sasia e ujit të prodhuar, ngritja e shkallës së faturimit, zvogëlimi i humbjeve çfarëdo qofshin ato, ngritje e shkallës së inkasimit, ekuilibrimin e shpenzimeve operative me njësi të caktuara matëse, realizimin e projekteve të reja investive të financuar nga burimet vetanake të kompanisë etj.

Për ta përcjellë ecurinë e rrjedhave tarifore në sektorin e shërbimeve të ujësjellësit dhe të kanalizimit, tarifën e përcaktuara sipas procesit rregullator janë përmblyllur për tri vitet e theksuara (2009, 2010 dhe 2011) gjatë fundit vitit 2008, të cilat po i prezantojmë në formë tabelare për krahasim më të lehtë. Tarifën e dhëna janë pa TVSH.

Pasqyra e tarifave të aprovuara është dhënë e përmbledhur në tabelën vijuese (Tabela2), duke theksuar se viti 2009 është viti historik tani, pasi që këtë vit e kemi lënë pas.

Tabela 2: Tarifat e aprovuara për Shërbimet e Ujësjellësit dhe Kanalizimit: 2009-2011

Kompania Regjionale	Kategoria e tarifave	Njësia	Tarifa për Konsumatorë Shtëpiak			Tarifa për Konsumatorë Jo-shtëpiak		
			2009	2010	2011	2009	2010	2011
KUR 'PRISHTINA' Prishtinë	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.30	0.32	0.34	0.72	0.76	0.81
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.03	0.04	0.04	0.07	0.09	0.10
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.33	0.36	0.38	0.79	0.85	0.91
KUR 'HIDROREGJIONI JUGOR' Prizren	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.22	0.24	0.27	0.46	0.51	0.57
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.04	0.04	0.04	0.05	0.08	0.08
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.26	0.28	0.31	0.54	0.59	0.65
KUR 'HIDRODRINI' Pejë	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.17	0.18	0.19	0.41	0.42	0.43
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.05	0.05	0.05	0.07	0.08	0.09
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.22	0.23	0.24	0.48	0.50	0.52
KUR 'RADONIQI' Gjakovë	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.27	0.28	0.29	0.57	0.62	0.64
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.05	0.05	0.05	0.11	0.11	0.11
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.32	0.33	0.34	0.68	0.73	0.75
KUR 'MITROVICA' Mitrovicë	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.25	0.27	0.28	0.60	0.62	0.64
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.09	0.10	0.11	0.14	0.15	0.18
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.34	0.37	0.39	0.74	0.77	0.82
KUR 'HIDROMORAVA' Gjiçan	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.28	0.29	0.30	0.60	0.62	0.64
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.07	0.07	0.07	0.10	0.11	0.12
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.35	0.36	0.37	0.70	0.73	0.76
KUR 'BIFURKACIONI' Ferizaj	Fikse	EUR/muaj	1.00	1.00	1.00	3.00	3.00	3.00
	Volumetrike - Uji	EUR/m3	0.28	0.29	0.29	0.70	0.72	0.73
	Volum.-Kanalizim	EUR/m3	0.05	0.05	0.06	0.13	0.13	0.15
	Volum.-Mesatare	EUR/m3	0.33	0.34	0.35	0.83	0.85	0.88

Siç mund të shihet nga Tabela 3, tarifat fikse kanë mbetur të pandryshuara (1,0 EUR/muaj për konsumatorët shtëpiak, dhe 3.0 EUR/muaj për konsumatorët komercial dhe institucional), ndërsaq tarifat volumetrike janë ngritur në mënyrë të shkallëzuar për periudhën e ardhshme trevjeçare. Ngritja e tarifave volumetrike është bërë në një masë relativisht të vogël dhe ka marrë parasysh rrethanat ekonomiko-sociale në Kosovë respektivisht mundësitë paguese të familjeve kosovare.

Për të pasqyruar ma saktë të dhënat e tarifave të ngritura, në vazhdim do të prezantojmë tarifat specifike ma të larta dhe atë më të ulëta të sektorit për të tri vitet e këtij procesi rregullatorë, me qellim të krahasimit ma të lehtë,

Për këtë qellim po japim të dhënat e theksuara për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak, për tarifa volumetrike sasiore të cilat janë ndikuar me procesin e theksuar rregullatorë;

- Gjatë vitit 2009 ngritjen ma të lartë të tarifës mesatare volumetrike të ujit të shërbyer e ka arritur KRU “Hidromorava” Gjilan në lartësi 16.6 %, ndërkaj ngritja më ulët e tarifës së njëjtë është bërë te KRU “Hidrodrini” Pejë në masën 4.7%.
- Për vitin 2010 ngritja më e theksuar e tarifës mesatare volumetrike për konsumatorët shtëpiakë është bërë te KRU “Prishtina” Prishtinë në masën prej 9,09% dhe ajo ma e ulët në masën prej vetëm 2.8% te KRU “Hidromorava” Gjilan.
- Gjatë vitit 2011 ngritje më të theksuar të tarifës mesatare volumetrike është aprovuar te KRU “Hidroregjioni-Jugor” në Prizren për 10,7% dhe ajo ma e ulëta serish te KRU “Hidromorava” Gjilan në lartësinë prej 2,8%.

Gjatë udhëheqjes së procesit të theksuar rregullatorë, ZRRUM ka bërë të qartë se do të rishqyrtojë tarifat e përcaktuara me rivlerësimin e rrethanave të reja të rikrijuara ekonomike, duke i ndërlidhë të njëjtat edhe me përmbushjen e cazeve të përcaktuara me procesin rregullatorë.

Gjetjet tona për vitin 2009 kanë dëshmuar se pritjet tona nuk kanë qenë jo reale, pasi që kompanitë kanë dështuar në përmbushjen e cazeve të përcaktuara me procesin rregullatorë 2009 – 2011 edhe pse të dhënat e përmbledhura për vitin 2009 nuk janë përmbyllë tërësisht gjerë me tani.

3.3.2. Investimet e Planifikuara në Sektorin e Ujësjellësit dhe Kanalizimit gjatë Periudhës së Ardhsme 3-vjeçare

Është me rëndësi të theksohet se me aprovimin e tarifave të reja janë parapa të ndërmerren investime të konsiderueshme nga të gjitha kompanitë e ujësjellësit në vlerë totale prej mbi 140 milion EUR, investime këto që janë të domosdoshme në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit dhe të cilat do të mundësojnë shërbime më cilësore për konsumatorë. Realizmin e këtyre investime ZRRUM do ta monitorojë ngushtë.

Siç mund të shihet në Tabelën 3, pjesa më e madhe e investimeve kapitale pritet të financohen nga donacionet dhe grantet. Megjithatë, vlera prej mbi 23 milion EUR që planifikohet të investohen nga të hyrat vetanake të kompanive është një hap i rëndësishëm që demonstroi qëndrueshmërinë e tyre financiare dhe rritjen graduale të kapaciteteve financuese të kompanive të ujësjellësit.

Tabela 3: Investimet Kapitale të Planifikuara nga Kompanitë e Ujësjellësit: 2009-2011

Nr.	Kompanitë Regjionale të Ujit (KUR)	Investimet 2009-2011		Gjithsejt
		Vetanake	Grante	
1	'PRISHTINA' Prishtinë	9,217,000 €	67,980,300 €	77,197,300 €
2	'HIDROREGJIONI JUGOR' Prizren	2,023,900 €	34,566,100 €	36,590,000 €
3	'HIDRODRINI' Pejë	3,751,600 €	1,290,000 €	5,041,600 €
4	'RADONIQI' Gjakovë	2,493,800 €	9,261,000 €	11,754,800 €
5	'MITROVICA' Mitrovicë	1,971,700 €	1,569,540 €	3,541,240 €
6	'HIDROMORAVA' Gjiilan	1,126,600 €	1,620,000 €	2,746,600 €
7	'BIFURKACIONI' Ferizaj	2,450,500 €	1,575,000 €	4,025,500 €
Investimet totale në sektor:		23,035,100 €	117,861,940 €	140,897,040 €

Procesi i aprovimit të tarifave të reja është zhvilluar në konsultim të ngushtë me Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve, ashtu siç edhe parashihet me ligj. Këto Komisione janë trupa të themeluar në 7 Regjionet e Kosovës ku ofrohen shërbimet e kompanive regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe të njëjtat përbëhen nga përfaqësuesit e të gjitha komunave të Kosovës të cilët përfaqësojnë interesat e të gjitha kategorive të konsumatorëve.

3.3.3. Përcaktimi i Tarifave për Shërbimet e Mbeturinave

Pas harmonizimit kohorë të tarifave të shërbimet për grumbullimi të mbeturinave me

shërbimin e administrimit të tyre në deponit e përhershme gjatë procesit tarifarë 2009/10, ZRRUM gjatë vitit 2009 ka përcaktuar tarifat e këtij shërbimi publik për 5 kompani

që merren me grumbullim dhe transportim të mbeturinave në deponi të caktuara, të cilat kishin aplikuar për vlerësim të aplikacioneve të tyre gjatë pjesës së parë të vitit të kaluar, ndërsa për dy të tjerat që nuk kanë aplikuar për ngritje të tarifave i u janë vazhduar tarifat ekzistuese të vitit 2007/2008.

Në të njëjtën kohë ZRRUM ka përcaktuar edhe tarifën e shërbimit për kompaninë e cila

merret me menaxhim të deponive të mbeturinave KMDK e cilat i ka nën administrim deponit për grumbullimin dhe menaxhimin e mbeturinave.

Tarifat e përcaktuar për gjashtë kompanitë që merren me menaxhim dhe administrim të mbeturinave janë një vjeçare dhe të njëjtat do të rishikohen dhe rivilësohen gjatë pjesës së parë të vitit 2010.

Duhet theksuar se tarifat e KRM-ve janë grupuar në tri grupe të shfrytëzuesëve të shërbimeve të tyre;

- konsumatorët shtëpiak,
- konsumatorët komercial-industrial, dhe

- konsumatorët institucional

Brenda kategorive të konsumatorëve komercial-industrial dhe ata institucional kemi nën

kategori të caktuara dhe nga dy zona shërbimesh.

Në tabelën si më poshtme po i ofrojmë të dhënat e tarifave të përcaktuara për kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë me procesin e rregullt rregullatorë të vitit të kaluar, me vlefshmëri prej **1 qershori 2009 gjerë me 31 maj 2010**. Duhet theksuar se tarifat e tilla janë pa TVSH.

Numri rendor	Emërtimi i kompanive	Tarifa e shërbimit €/muaj
1	KRM "Çabrati" Sh. a. Gjakovë	4,22
2	KRM "Pastrimi" Sh. a. Prishtinë	4,14
3	KRM "Pastërtia" Sh. a. Ferizaj	4,01
4	KRM "Higjiena" Sh. a. Gjilan	3,74
5	KRM "Eko-Regjioni" Sh. a. Prizren	3,65
6	KRM "Ambienti" Sh. a. Pejë	3,45
7	KRM "Uniteti" Sh. A. Mitrovicë	3,45
8	KMDK Sh. a. Prishtinë	5,26 €/ton

Për shkak të hapësirës dhe ndërlikushmerisë së prezantimit, ZRRUM nuk i pasqyron tarifat e konsumatorëve të tjerë, por për çfarëdo qoftë inëtersimi jemi të gatshëm të ofrojmë të dhëna sqaruese.

3.4. PROMOVIMI I INTERESAVE TË KONSUMATORËVE

3.4.1. Zbatimi i standardeve të shërbimit

Me qëllim të përmirësimit të standardeve të shërbimeve ndaj konsumatorëve, nga ana e ZRRUM-it janë ndërmarrë aktivitete të gjithanshme si: organizimi i punëtorive dhe debateve me kompanitë dhe palët e tjera të interesit ku janë diskutuar dhe janë bartë përvojat më të mira ndërmjet kompanive, dhënia e rekomandimeve për kompanitë e ujit dhe kërkimi i zotimeve specifike nga to për përmbushjen dhe përmirësim të ndjeshëm të nivelit të shërbimeve ndaj konsumatorëve.

Si rezultat i këtyre aktiviteteve, në pothuajse të gjitha kompanitë e ujit janë themeluar zyra për relacione me konsumatorë. Këto zyra janë pajisur me personel dhe infrastrukturë të nevojshme për trajtimin efikas të ankesave të konsumatorëve. Rrjedhimisht, në vitin 2009 kompanitë e ujit dhe mbeturinave kanë qenë me azhure në shqyrtimin dhe zgjidhjen e kërkesave dhe ankesave të konsumatorëve në pajtim me standardet minimale të shërbimit të përcaktuara me rregullat e ZRRUM-it.

Poashtu, në bashkëpunim të ngushtë me Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK), ZRRUM në vazhdimësi ka përcjellur cilësinë e ujit të pijes dhe me kohë ka reaguar kur ka pasur dështime të cilësisë së ujit.

3.4.2. Trajtimi i ankesave të konsumatorëve përmes KKK-ve

ZRRUM-i edhe këtë vit ka vazhduar të ju ofrojë Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK), mbështetje të gjithanshme si organizative ashtu dhe logjistike me qëllim që të ngritet profili dhe efektiviteti i tyre

KKK në secilën prej zonave të shërbimit të kompanive rajonale janë takuar në baza mujore, gjatë këtyre takimeve janë shqyrtuar dhe zgjidhur një numër i konsiderueshëm i ankesave të konsumatorëve si dhe janë shqyrtuar konteste (ankesat) të ndryshme në mes konsumatorëve dhe kompanive përkatëse.

Gjatë vitit 2009 janë mbajtur 77 takime të rregullta të KKK ku përveç pikave të ndryshme në interes për konsumatorët janë shqyrtuar 230 çështje dhe janë trajtuar 26 ankesa të konsumatorëve prej të cilave janë zgjidhur gjithësejt 16 ankesa. Dy ankesa iu kjanë kthyer palëve për plotësim ndërkaq tetë ankesa i janë referuar KUR "Prishtina" për ti zgjidhur.

Në anën tjetër, me qëllim të ngritjes së profilit të KKK-ve dhe njëkohësisht edhe njohuritë e konsumatorëve për të drejtat e tyre, ZRRUM-i ka përgatitur dhe ka publikuar në tri gjuhët zyrtare në një numër të konsiderueshëm (mbi 100.000) fletëpalosje të cilat përmbajnë informacione të dobishme për konsumatorët në lidhje me parashtrimin e ankesave. Fletëpalosjet janë shpërndarë tek konsumatorët nga kompanitë regjionale të ujësjellësit dhe kanalizimit.

4. Aktivitetet në Konsolidimin Institucional

3.2. AKTIVITETET NË PLANIN LEGJISLATIV

(i) Amendamenti i Legjislacionit Primar

Me aprovimin e Ligji Nr. 03/L-086, përgjegjësia e ZRRUM është transferuar nga UNMIK/PSSP tek Kuvendi i Kosovës.

Themelimi dhe funksionimi i ZRRUM si autoritet i pavarur rregullator bazohet në nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ndërkaq bazën ligjore për veprimtarinë e ZRRUM si rregullator ekonomik i veprimtarisë së ndërmarrjeve publike që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, kanalizimit dhe mbeturinave e paraqet Ligji Nr. 03/L-086.

Meqenësë Ligji Nr. 03/L-086 nuk e ka ndryshuar përmbajtjen e Rregullores 2004/49, përpos që ka transferuar përgjegjësitë nga UNMIK-u te Kuvendi i Kosovës, ZRRUM, në vitin 2009, ka inicuar dhe është angazhuar për amendamentimin e këtij ligji. Kjo iniciativë është filluar me qëllim të harmonizimit të këtij ligji me legjislacionin tjetër në fuqi dhe me qëllim të definimit më të mirë të disa aspekteve të cilat janë evidentuar si problematike gjatë këtyre viteve të zbatimit të tij. Konkretisht, arësytet për amendamentimin e Ligjit Nr.03/L-086 respektivisht Rregullores 2004/49, janë:

- Ndryshimin e emërimit të Rregullatorit në pajtim me emërimet e agjensioneve sipas Kushtetutës dhe rregullatorëve tjerë si motra,
- Autorizimi legjislativ i nxjerrjes së akteve administrative,

- Ndryshimi i strukturës qeverisëse të ZRRUM që aktualisht është përmes Drejtorit dhe Zv.Drejtorit me një strukturë të Bordit⁶
- Përcaktimi më i qartë i obligimeve raportuese të ZRRUM ndaj Kuvendit të Kosovës në njërën anë, dhe i obligimeve raportuese të kompanive të ujësjellësit ndaj ZRRUM në anën tjetër
- Definimi më i saktë i statusit financiar të ZRRUM si autoritet që financohet nga taksat e licencimit të cilat i paguajnë ndërmarrjet publike të licencuara
- Rishikimi i disa dispozitave që kanë të bëjnë me tarifat dhe me rregullimin e borxheve të vjetra

ZRRUM, duke qenë koshient për rëndësinë e amendamenteve të mësipërme, do të angazhohet në bashkëpunim me institucionet tjera (Kuvendin e Kosovës, Qeverinë e Kosovës, MMPH, MEF, MAPL dhe Asociacionin e komunave) që ky aktivitet të kryhet gjatë vitit 2010.

(ii) Amendamenti i Legjislacionit Sekundar – Rregullat e ZRRUM

Në janar të vitit 2005, ZRRUM ka nxjerrë 14 akte nënligjore (Rregulla) në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2004/49 të cilat Rregulla më detajisht i rregullojnë aspektet e caktuara që janë në kuadër të autorizimeve dhe përgjegjësi të tij si: licencimi, tarifat, standardet e shërbimit, karta e konsumatorëve, shqyçja etj.

Pas miratimit të Ligjit Nr. 03/L-086, ZRRUM ka filluar procesin e amendamentimit të këtij legjislacioni sekundar (Rregullave). Rrjedhimisht, gjatë periudhës prill-dhjetor 2009 ka amendamentuar Rregullën për Standarde të Minimale të Shërbimit. Amendamenti i Rregullave përpos që reflekton ndryshimet e legjislacionit primar (amendamentimin e Rregullores 2004/49 me Ligjin Nr. 03/L-086) ka përfshi edhe disa ndryshime dhe evitimin e disa mangësive të cilat janë identifikuar gjatë periudhës 4-vjeçare të zbatimit të këtyre Rregullave.

4.2. STATUSI FINANCIAR I ZRRUM

ZRRUM, në pajtim me nenin 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, duke qenë institucion i pavarur, e financuar nga aktivitetet e veta nga taksat e licencimit që i paguajnë kompanitë e licencuara. Kjo formë konsiderohet si forma më e përshtatshme për financimin e rregullatorëve ekonomik (meqenëse nuk parqet ngarkesë për buxhetin qendror të shtetit) dhe është praktikë pothuajse standarde në shumicën e vendeve ku zbatohet regjimi i rregullimit ekonomik për shërbime të catuara publike.

Në vitin 2009 ZRRUM përfundimisht ka arritur të tejkalojë vështirësitë dhe barrierat burokratike që deri atëherë ka pasur dhe rrjedhimisht është arritur të funksionalizohet në praktikë pavarësia e plotë financiare në shfrytëzimin e buxhetit të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës.

4.3. MBËSHTETJA FINANCIARE NGA DONATORËT

⁶ Të gjitha agjencitë dhe autoritetet rregullatore të pavarura në Kosovë (përpos ZRRUM) qeverisen prej një organi kolegjial –Bordit. Prandaj, ky përjashtim do të duhej riparuar, dhe rrjedhimisht edhe për ZRRUM të parashihet krijimi i Bordit si organ që mbikqyrë punën e menaxhmentit dhe merr vendime rregullatore. Për hir të një qasje konsistentecës në

ZRRUM ka ndërtuar raporte të shkëlqyeshme të bashkëpunimit me të gjitha institucionet donatore në Kosovë. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2009, ka vazhduar përkrahja e Zyrës Zvicëranë për Bashkëpunim (SDC) në kuadër të projektit i cili ka filluar në janar të vitit 2008.

Ky projekt, edhpsë ka qenë planifikuar të përfundojë në fund të vitit 2009, me marrëveshje të përbashkët është arritur pajtimi që të vazhdojë deri në fund të qershorit 2010.

Në anën tjetër, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit European (ZNKE) e ka mbështetur aplikacionin e ZRRUM të bërë në vitin 2009 për mbështetje institucionale të ZRRUM gjatë viteve 2010-2012. Projekti i ri i cili do të ofrojë mbështetje për ZRRUM dhe Kompanitë regjionale të Ujit në fushën e tarifave dhe kontabilitetit rregullator është aktualisht në fazat përfundimtare dhe pritet që të fillojë në muajin prill-maj 2010.

5. Relacionet e Jashtme

5.1. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT DHE INSTITUCIONET TJERA NË KOSOVË

Në pajtim me orientimet strategjike të ZRRUM për bashkëpunim të hapur dhe të mirëfilltë me të gjitha palët e interesit të sektorit të ujit dhe mbeturinave në Kosovë, e me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për arritjen e përmirësimeve të nevojshme në këta sektorë, ZRRUM edhe në vitin 2009 ka vazhduar qasjen e tij të hapur dhe bashkëpunuese me rregullatorët tjerë të këtyre sektorëve si dhe me palët tjera të interesit.

(i) Bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike (IKSHPK)

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit që kemi nënshkruar me IKSHPK në vitin 2007, ZRRUM ka vazhduar bashkëpunimin e shkëlqyeshëm në fushën e monitorimit të standardeve të kualitetit të ujit të pijes që ofrojnë kompanitë publike të licencuara.

Përpos takimit të rregulltë vjetor që kemi pasur në muajin shkurt, bashkëpunimi ka konsistuar në shkëmbimin e rregulltë të informacioneve me interes të dy palëve. Në këtë plan, në Raportin Vjetor të Performancës 2008 për kompanitë e ujësjellësit, ZRRUM ka shfrytëzuar të dhënat e IKSHPK. Rrjedhimisht, në bashkëpunim të ngushtë me IKSHPK (si dhe MMPH, SHUKOS, donatorët) kemi shpallur kompaninë më të mirë të ujësjellësit për vitin 2008 dhe kemi organizuar ceremoninë e ndarjes së çmimeve në muajin Gusht 2009. ZRRUM është i përkushtuar që ky bashkëpunim të intensifikohet edhe më shumë në të ardhmen.

(ii) Bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MMPH)

Duke pasur parasysh rolin e MMPH si autoritet kryesor për menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë dhe si rregullator mjedisor i sektorit të ujit dhe mbeturinave, ZRRUM edhe gjatë vitit 2009 ka vazhduar bashkëpunimin me MMPH në sektorët e ujit dhe mbeturinave.

Për më tepër relacionet me MMPH kanë shënuar një ngritje në kuptim të takimeve të rregullta dhe në kuptim të pjesëmarrjes së ndërsjellë në takimet punuese apo workshopet që ka organizuar ZRRUM respektivisht MMPH. Drejtori i ZRRUM ka pasur disa takime me Ministrin e MMPH në të cilat janë diskutuar problemet aktuale në sektorin e ujërave dhe në veqanti atë të mbeturinave dhe me këtë rast janë diskutuar edhe çështjet që lidhen me harmonizimin e legjislacionit në këta sektorë me qëllim të përcaktimit të qartë të rolit dhe përgjegjësiwe institucionale në sektorin e ujit dhe mbeturinave.

ZRRUM ka marrë pjesë aktive në të gjitha workshopet dhe Takimet Punuese të rëndësishme që ka organizuar MMPH gjatë vitit 2009, qoftë në lidhje me sektorin e ujit (workshopi për strategjinë e investimeve, workshopi për pellgjet lumore etj.) poashtu edhe në lidhje me sektorin e mbeturinave (takimet punuese për iniciimin e hartimit të planit strategjik etj.). ZRRUM edhe në lidhje me MMPH është fuqimisht i përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit edhe në të ardhmen në interes të koordinimit të veprimeve për progresin e sektorit të ujërave dhe mbeturinave.

(iii) Bashkëpunimi me Njësinë për Politika dhe Monitorim (NJPM) të MEF

Pas marrjes së përgjegjësiwe nga MEF, respektivisht nga Njësia për Politika dhe Monitorim (NJPM) e MEF-it në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ZRRUM ka vazhduar bashkëpunimin me këtë subjekt në të cilat janë diskutuar problemet e shfaqura në operimin e ndërmarrje publike qendrore.

(iv) Bashkëpunimi me Palët tjera

Në vitin 2009, ZRRUM ka bashkëpunuar edhe palët tjera të interesit në kuadër të domenit të përgjegjësiwe të veta. Vlen të përmendet këtu bashkëpunimi me:

- Agjencinë për Integritet Europiane (AEI) në lidhje me hartimin e PVPE ;
- Agjencinë Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM);
- Shoqatën e Kompanive të Mbeturinave (PAMKOS);
- Asociacionin e Komunave të Kosovës; dhe me
- Përfaqësuesit e donatorëve (USAID, KfW, SCO, GTZ etj.) dhe konsulentëve (Rodeco, IRD, EPTISA etj.) që kanë qenë aktiv në sektorin e ujërave dhe mbeturinave në Kosovë.

Me të gjitha këto palë, qoftë në takime të drejtpërdrejta apo në punëtori dhe konferenca janë diskutuar zhvillimet në sektorët e ujit dhe mbeturinave dhe është paraqitur qëndrimi i ZRRUM lidhur me problemet aktuale në këta sektorë.

5.2. BASHKËPUNIMI ME RREGULLATORËT E UJIT NË REGJION DHE NË EUROPE

Bashkëpunimin me rregullatorët tjerë të sektorit të ujërave ZRRUM e konsideron me rëndësi vitale për shkëmbimin e përvojave dhe për adoptimin e praktikave të mira në fushën e zbatimit të rregullimit ekonomik të shërbimeve të ujit.

Në këtë plan, në vitin 2009, ZRRUM ka vazhduar të bashkëpunojë me rregullatorët ekonomik të shërbimeve të ujit të: Portugalisë (IRAR), Skotlandës (WICS), dhe Shqipërisë (ERRU), bashkëpunim ky i inicuar më herët.

- Në anën tjetër, bashkëpunimi me rregullatorin e shërbimeve të ujit të Portugalisë i inicuar në fund të vitit 2007, ka vazhduar me shkëmbimin e informacioneve si dhe

me shkëmbimin e Raporteve Vjetore të Performancës 2009 të Kosovës respektivisht Portugalisë.

- Dhe në fund, me Entin Rregullator të Ujit (ERRU) të Shqipërisë kemi nënshkruar **Marrëveshjen e Bashkëpunimit në prill të vitit 2009**. Në këtë ngjarje e cila është mbajtur në prishtinë me iniciativën e ZRRUM, kanë marrë pjesë Ministrat e Mjedisit të Kosovës dhe Shqipërisë si dhe zyrtarë të lartë të të dy vendeve tona.

5.3. BASHKËPUNIMI ME MEDIA - RELACIONET ME PUBLIKUN

Duke pasur parasysh faktin se koncepti i rregullativës ekonomike të shërbimeve publike është koncept relativisht i ri në Kosovë dhe rrjedhimisht njohuritë e përfaqësuesve të institucioneve Kosovare dhe publikut të gjërë për këtë koncept janë mjaft të kufizuara, ZRRUM në vitin 2009 është angazhuar që përmes formave të ndryshme të ndikojë në njoftimin e institucioneve dhe publikut të gjërë për atë se çfarë është roli dhe funksioni i rregullativës ekonomike që e zbaton ZRRUM.

6. Aspektet Financiare

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-086 (neni 8.4), si burim kryesor për financimin e aktiviteteve të ZRRUM janë taksat e licencimit që i paguajnë ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave. Lartësia e taksave të licencimit caktohet në bazë vjetore sipas kriterëve vijuese:

- të hyrat nga këto taksa duhet të korrespondojnë me shpenzimet e planifikuara të ZRRUM për vitin respektiv, me kusht që
- lartësia e taksës mos të tejkalojë 1.5% të qarkullimit bruto vjetor të ofruesve të shërbimeve.

Në rast të problemeve që eventualisht do të paraqiteshin në arkëtimin e taksës së licencimit nga kompanitë e licencuara, ZRRUM ka të drejtë të kërkojë mjete nga buxheti i Kosovës në pajtim me Ligjin për Buxhetin e Kosovës 2009, për të mos u rrezikuar funksionimi i tij.

Poashtu, projekte dhe aktivitete të caktuara të ZRRUM mund të financohen nga donacionet e agjencive donatore si dhe nga grantet qeveritare.

Buxheti vjetor i ZRRUM aprovohet nga Kuvendi i Kosovës. Me rastin e parashikimit të shpenzimeve të veta ZRRUM udhëhiqet nga parimet e operimit eficient financiar me qëllim që rregullimi ekonomik i shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave të mos këtë kosto të lartë për konsumatorët.

6.1. SHPENZIMET

Edhe pse, ZRRUM të gjitha transakcionet financiare i kryen përmes sistemit të Thesarit, që për pasojë ka mbajtjen e kontabilitetit financiar të ZRRUM nga Thesari (sikurse edhe për të gjitha organizatat tjera buxhetore), megjithatë ZRRUM mban kontabilitetin e vet financiar dhe material dhe për çdo tre muaj bën barazimin me departamentin e Thesarit.

Për vitin fiskal 2009, ZRRUM ka pasur në dispozicion mjete financiare në lartësi 344,520.00 EUR, prej të cilave: 293,264.07 EUR të alokuara nga BKK .

Në tabelën mëposhtë (Tabela 4) është dhënë një pasyrë e burimeve financiare që ka pasur në dispozicion ZRRUM në vitin fiskal 2008 si dhe shpenzimeve të realizuara.

Tabela 16: Buxheti i ZRRUM për 2009

Kategoria e Shpenzimeve	Të buxhetuara (EUR)	Të realizuara (EUR)
Paga dhe Mëditje	155,570.00	130,897.51
Mallëra dhe shërbime	184,300.00	158,391.07
Shpenzime Kapitale	-	-
Shërbimet Komunale/Publike	4,650.00	3,975.49
Total Buxheti	344,520.00	293,264.07

6.2. MBËSHTETJA NGA DONATORËT

Duhet të theksohet se përpos këtyre mjeteve, ZRRUM në vitin 2009 ka pasur mbështetje insitucionale nga donatorët (SDC) në formën e asistencës teknike (të dhënat e sakta financiare ZRRUM nuk i posedon meqenëse menaxhimi financiar i projekteve është bërë nga vet donatorët).

6.3. TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT

Për vitin 2009, ZRRUM ka faturuar kompanive të licencuara të ujit dhe mbeturinave në emër të taksës së licencimit vlerën totale prej: **342,042.90 EUR**.

Përderisa pagesa e taksës së licencimit nga ana e kompanive të ujit ka qenë më e mirë (90.36%), kompanitë e mbeturinave me pretekstin e vështirësive financiare, në përgjithësi kanë pasur një shkallë shumë të ulët të pagesës (vetëm 1.99%), duke mos përmbushur obligimet e tyre ndaj ZRRUM të përcaktuara me ligj. Edhe pse ZRRUM ka të drejtë të revokojë licencën e shërbimit në rast mospagese të taksës së licencimit, ZRRUM nuk e ka ndërmarrë deri tashti një veprim të tillë. Me konsituimin e Bordeve të këtyre ndërmarrjeve dhe me qartësimin e statusit pronësor të tyre, ZRRUM konsideron se janë krijuar kushte më të volitshme për përmirësimin e shkallës së pagesës së kompanive të licencuara (në veçanti të atyre të mbeturinave) të taksës së licencimit.

(i) Të hyrat e Realizuara nga Kompanitë e Ujit

Në vitin 2009, ZRRUM ka faturuar për kompanitë e ujit në total: **227,281.57 EUR**. Prej kësaj shume janë arkëtuar gjithësej: **205,370.68 EUR apo 90.36%** .

Tabela 6: Pagesa e Taksës së Licencimit nga Kompanitë e Uji

Emri i Kompanisë	Regjioni	Taksa Vjetore	Taksa Mujore	Total pagesa 2009	Të paguara për 2008 në 2009	Total pagesa
KUR "RADONIQI" SH.A	GJAKOVË	26,972.00	2,247.67	17,981.36	7,535.72	25,517.08
KUR "HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A	PRIZREN	24,646.40	2,053.87	20,538.70	3,411.22	23,949.92
KUR "MITROVICA" SH.A	MITROVICË	30,139.59	2,511.63	25,116.30	0.00	25,116.30
KUR "BIFURKACIONI" SH.A	FERIZAJ	9,963.26	830.27	8,302.70	0.00	8,302.70
KUR "PRISHTINA" SH.A	PRISHTINË	93,175.20	7,764.60	93,175.20	7,281.63	100,456.83
KUR "HIDRODRINI" SH.A	PEJË	26,287.70	2,190.64	26,287.68	0.00	26,287.68
KUR "HIDROMORAVA" SH.A	GJILAN	12,771.99	1,064.33	10,643.30	2,011.88	12,655.18
NH "IBER LEPENCI " SH.A	PRISHTINË	3,325.43	277.12	3,325.44	0.00	3,325.44
Totali:		227,281.57	18,940.13	205,370.68	20,240.45	225,611.13

Nga pasqyra e mësipërme mund të shihet se pagesën e rregulltë dhe të plotë të taksës së licencimit e kanë kryer:

- KHE "Ibër-Lepenci" Prishtinë,
- KUR " Prishtina"
- KUR Hidrodrini" Pejë, , dhe
- KUR "Hidromorava

Ndërkaq, kompanitë të cilat nuk kanë kryer obligimet e tyre ligjore të pagesës së plotë të taksës së licencimit janë:

- KUR "Bifurkacioni" Ferizaj (83%),
- KUR "Mirtovica " Mitrovic (83%), dhe
- KUR "Hidroregjioni Jugor" (97%)

(ii) Të hyrat e Realizuara nga Kompanitë e Mbeturinave

Në vitin 2009, ZRRUM ka faturuar për kompanitë e mbeturinave në total: 114,761.33 EUR. Prej kësaj shume janë arkëtuar vetëm: 2,283.82 EUR.

Tabela 7: Pagesa e Taksës së Licencimit nga Kompanitë e Mbeturinave

Emri i Kompanisë	Rgjioni	Taksa Vjetore	Taksa Mujore	Total të paguara	Të paguara për 2008 në 2009	Total pagesa
KRM "HIGJIENA" SH.A	GJILAN	13,702.89	1,141.91	2,283.82	0.00	2,283.82
KRM "EKOREGJION" SH.A	PRIZREN	16,979.10	1,414.93		0.00	0.00
KRM "PASTRIMI" SH.A	PRISHTINË	37,107.04	3,092.25		0.00	0.00
KRM "AMBIENTI" SH.A	PEJË	9,733.56	811.13		0.00	0.00
KRM "UNITETI" SH.A	MITROVICË	11,256.03	938.00		0.00	0.00
KRM "PASTERTIA" SH.A	FERIZAJ	9,983.01	831.92		0.00	0.00
KRM "ÇABRATI" SH.A	GJAKOVË	6,703.98	558.67		0.00	0.00
Kompania "KMDK" SH.A	PRISHTINË	9,295.72	774.64		0.00	0.00
Totali:		114,761.33	9,563.45	2,283.82		2,283.82

Nga Tabela e mësipërme mund të shihet se "Pastrimi" Prishtinë, "Ambienti" Pejë, "Çabrati" Gjakovë dhe "Ekoregjioni" Prizren, "Uniteti" Mitrovicë si dhe KMDK Prishtinë nuk kanë kryer asnjë pagesë të vetme në përjashtim të KRM "Higjena" Gjilan e cila ka paguar dy këste në emër të taksës së licencimit. ZRRUM do të tentojë që në bashkëpunim institucional me Bordet e këtyre kompanive të adresojë problemin e pagesës së taksës së licencimit, dhe në rast se nuk arrihet ndonjë efekt nga kjo, atëherë ZRRUM do të konsideroj seriozisht revokimin e licencës së shërbimit për këto kompani.

ASETET E ZRRUM

Duke pasur parasysh ligjet e zbatueshme në Kosovë mbi themelimin e institucioneve të Kosovës, pastaj Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës si dhe Rregulloret e Thesarit, institucionet buxhetore vetëm e bëjnë regjistrimin e aseteve, ndërsa amortizimin e tyre e bën departamenti i Thesarit.

Vlera e aseteve në ZRRUM që nga viti 2005 e deri me 31.12.2009 ka arritur në: 96,582.00 EUR.

Tabela 8: Vlera e Aseteve të ZRRUM

Nr.	Lloji i Aseteve	Vlera e Aseteve
1	Vetura	74,012.00€
2	Inventar, Pajisje, TI etj.	22,570.00€
Total:		96,582.00€